

VENDIM
Nr. 7, datë 15.1.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR
ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA
PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, brenda afatit të aplikimit për rinovim.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 335, datë 18.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.12.2025 dhe 22.12.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2825/4 prot., datë 24.12.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20 prot., datë 6.1.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin shtesë, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

- Informacion të përditësuar në lidhje me statusin e shqyrtimit gjyqësor, në lidhje me detyrimet tatimore.

- Informacion të përditësuar në lidhje me stafin aktual efektiv që angazhohet me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Planin e biznesit të përditësuar me kostot, shpenzimet dhe të ardhurat përkatëse.

- Vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë ku të dedikohet shuma përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë.

- Informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë”.

- Për sa më lart, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti